




**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

ALBANIA

ICIC XV

**Empowering Individuals through
Access to Information:**
Ensuring Transparency and Inclusivity
in an Interconnected World

3 - 5 June 2024, Tirana

INFORMIM DHE PRIVATËSI

Nr. 17

Përmbajtja

“Fuqizimi i individëve nëpërmjet aksesit në informacion, sigurimi i transparencës dhe gjithëpërfshirjes në një botë të ndërlidhur”, Albania XV ICIC	faqja 3
“Të palëkundur në përkushtimin tonë për të nxitur transparencën e autoriteve publike”, nga fjala e Komisionerit Dervishi në Sesionin e Hapur	4
“E drejta për informim nuk është thjeshtë një instrument demokratik, por një parakusht për shëndetin dhe zhvillimin e demokracive funksionale”, nga fjala e Kryeministrit Rama në Sesionin e Hapur	5
Folës kryesorë	6
Paneli 1 - Fuqizimi i grupeve vulnerabël përmes aksesit në informacion dhe transparencës	7
Paneli 2 - Roli i shoqërisë civile dhe mediave në promovimin e aksesit në informacion dhe transparencës	8
Sesioni Paralel I - Transparencë proaktive përmes mjeteve digjitale dhe nismave për të dhënat e hapura	9
Sesioni Paralel II - Arritja e ekuilibrit të duhur midis të drejtës për informim dhe të drejtave të mbrojtjes së të dhënave në fushën digjitale	10
Paneli i UNESCO - Përgjatë zbatimit të Agjendës 2030	11
Takime Rrjeteve rajonale të ICIC	12
Raportime dhe mbyllja e punimeve të ditës së parë të Sesionit të Hapur	13
Raportimi i Grupeve të Punës të ICIC	14
Paneli 3 - E ardhmja e Konferencës ICIC	15
Mbyllja e punimeve të Sesionit të Hapur	16
Aktivitete paralele	17
Punimet e Sesionit të Mbyllur	18
Deklaratë Publike e XV ICIC	19-20
Njohuri të paçmueshme për të rritur transparencën dhe aksesin në informacion, fjala e Komisionerit Dervishi në mbyllje të Konferencës	21
XV ICIC, konsolidim i leadershipit të organizatës për promovimin e të drejtës për Informim	22

Revista **“Informim Dhe Privatësi”**

Redaksia: Redi Skënderaj, Alketa Koja, Segi Berberi, Denada Hysi, Brikena Tepelena.

Përgatitet dhe botohet nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Nr.17, Qershor 2024

Print: Graphic Line-01

“Fuqizimi i individëve nëpërmjet aksesit në informacion, sigurimi i transparencës dhe gjithëpërfshirjes në një botë të ndërlidhur”

Albania XV ICIC

Në datat 3-5 qershor 2024, Tirana mikpritri edicionin e 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (International Conference of Information Commissioners-ICIC). Organizimi i ngjarjes vjetore më të rëndësishme botërore për nxitjen e kulturës së transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike, Albania XV ICIC, iu besua për herë të parë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



Me pjesëmarrjen e mbi 200 përfaqësuesve të shteteve/juridiksioneve anëtare apo vëzhguese të ICIC nga të gjitha kontinentet, të organizatave ndërkombëtare si Këshilli i Evropës, UNESCO, Banka Botërore dhe OECD, nga bota akademike, shoqëria civile apo media, vendas dhe të huaj, përgjatë dy ditëve të Sesionit të Hapur, u zhvilluan 5 panele kryesore. Çështjet e trajtuara në to përfshinë diskutime për grantimin e ushtrimit të kësaj të drejte në kontekstin e grupeve vulnerabël, si dhe mbi ndërveprimin mes autoriteteve rregullatore të fushës me shoqërinë civile dhe median për ta bërë aksesin në informacion dhe transparencën sa më efektive – me pjesëmarrjen në panel edhe të përfaqësueses së Zyrës së Komisionerit. Sipas agjendës, pjesëmarrësit patën mundësi të ndiqnin një panel të ndarë në dy seksione mbi dinamizmin e mjedisit digjital dhe iniciativave për të dhënat e hapura, si

dhe për ekuilibrin që duhet mbajtur mes përparimit të aksesit në informacion dhe respektimin e të drejtave në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale – i moderuar nga përfaqësuesja e Zyrës së Komisionerit. Me interes për të pranishmit u ndoq edhe paneli kushtuar “Treguesit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm” të UNESCO, ku, ndër të tjera, në fokus është edhe miratimi i legjislacionit të kësaj fushe në sa më shumë shtete/juridiksione në botë, si dhe ai në lidhje me të ardhmen e kësaj organizate për të nxitur zgjidhjet inovative për fuqizimin e të drejtës për informim dhe transparencën.





“Të palëkundur në përkushtimin tonë për të nxitur transparencën e autoriteve publike”

**Nga fjala e Komisionerit Dervishi në
Sesionin e Hapur*

“Në kohët që jetojmë, me transformimin e shoqërisë dhe me teknologjinë moderne e inteligjencën artificiale, ne kemi mundësinë të kemi akses të menjëhershëm në informacion dhe të dhënat publike, edhe pse kjo e fundit na paraqet sfida të tjera, si në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Sot, mbi 120 vende në botë kanë një kuadër ligjor që garanton aksesin në informacion, fakt i cili tregon se si komuniteti ynë është rritur përgjatë këtyre viteve. Më duhet të theksoj se shoqëria civile, media, bota akademike apo të gjithë aktorët që operojnë në këtë fushë, luajnë një rol thelbësor në promovimin e transparencës me kontributin e vazhdueshëm të tyre”.



“Në Shqipëri, si në shumë pjesë të botës, ne e dimë zhgënjimin e qytetarëve kur ata hasin burokraci, kur informacioni i kërkuar nuk jepet në kohë, apo kur gazetarët e duan atë në çast për të bërë lajmin e tyre. Megjithatë, pavarësisht këtyre sfidave, ne duhet të mbetemi të palëkundur në përkushtimin tonë për të nxitur transparencën e autoriteteve publike duke respektuar ndërkohë kuadrin ligjor dhe parimet etike. Duke ndarë praktikat më të mira, duke shfrytëzuar teknologjitë e reja dhe duke u përkushtuar për përmirësim të vazhdueshëm, jam i bindur se ne mund të kapërcejmë barrierat tona”.

“E drejta për t’u informuar është gur themeli i demokracisë, transparenca, llogaridhënia, pjesëmarrja në vendimmarrje, lufta kundër korrupsionit, janë parime të cilat nuk mund të realizohen pa akses në informacion. Institucionet publike dhe zyrtarët e shteteve duhet të jenë të përgjegjshëm, duke siguruar që transparenca të mos jetë thjesht një ideal, por një praktikë dhe kulturë pune.

Rruga përpara është sfiduese, por gjithashtu plot me potencial të jashtëzakonshëm. Së bashku, mund të krijojmë një të ardhme ku informacioni buron lirshëm, rrjedh në shtratin e tij ligjor dhe derdhet në detin e madh të dijes, në shërbim dhe garanci për fuqizimin e çdo individi. Le t’i përkushtohemi kësaj kauze fisnike dhe të sigurojmë që aksesin në informacion të bëhet një realitet i prekshëm për të gjithë”.



“E drejta për informim nuk është thjeshtë një instrument demokratik, por një parakusht për shëndetin dhe zhvillimin e demokracive funksionale”

**Nga fjala e Kryeministrit Rama në Sesionin e Hapur*

“Jam shumë krenar për Komisionerin tonë dhe për Zyrën e Komisionerit, sepse puna që ai dhe ata kanë bërë është absolutisht e jashtëzakonshme dhe fakti që Zyra vlerësohet shumë lart përgjatë këtij rrugëtimit tonë që më në fund të bëhemi vend anëtar i BE është tejet frymëzuese. Në të njëjtën kohë, besoj, që për këdo këtu që është i ngjashëm me Shqipërinë, që do të thotë një vend në zhvillim, një demokraci në zhvillim, ne jetojmë në kohëra bekimi të madh që është teknologjia, teknologjia e re. Kjo teknologji na jep si vende në zhvillim një mjet që deri disa dekada më parë nuk ishte i pranishëm.



Nga ana tjetër, besoj po kështu, që po bekimi vjen bashkë me një mallkim që është kapaciteti, aftësia që kjo teknologji të përdoret për qëllime keqinformimi, për kaos apo dhe për konfuzion. E drejta për informim kështu përballlet me një kërcënim të madh, në të njëjtën kohë, kur kemi në dispozicion një mundësi të jashtëzakonshme, kështu që na takon ne ta përdorim sa më mirë, të vijojmë të investojmë në infrastrukturën digjitale dhe në programet e edukimit për t'u siguruar që të gjithë qytetarët të kenë qasje të përdorin me efektivitet të platformave digjitale”.

“Po ashtu, për të nxitur një kulturë transparence brenda institucioneve publike, duke nënvizuar rëndësinë e konsultimeve publike dhe qeverisjes me pjesëmarrje. Për të mos pasur frikë nga drita, por për ta përqafuar dritën dhe për të punuar shumë më ngushtë me institucionet si Zyra e Komisionerit, si Avokati i Popullit që e vlerësoj mjaft sa i takon punës që institucioni i bën, për të garantuar që të gjithë të kuptojnë, pikë së pari nga brenda qeverisë, që ekspozimi i informacionit dhe përdorimi i tij në maksimum për ta nxjerrë gjithçka në dritë është një ushtrim, një proces mjaft i shëndetshëm dhe një mjet mjaft efektiv kundër keqinformimit dhe dezinformimit”.



Folës kryesorë

*“Evolucioni i Shqipërisë drejt një shoqërie më të hapur, më demokratike dhe më përfaqësuese, është dëshmi e fuqisë transformuese të aksesit në informacion dhe transparencës” - nga fjala përshëndetëse e **z. Adrain Alcalá Méndez**, President i Bordit të Komisionerëve të INAI, Meksikë dhe njëkohësisht, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të ICIC.*



*“Pjesëmarrja në këtë Konferencë është tregues i angazhimit të përbashkët për të shqyrtuar rolin e rëndësishëm të aksesit në informacion në kuadër të transparencës, gjithëpërfshirjes dhe llogaridhënies në nivel global” - nga fjala e **z. Giuseppe Busia**, Kyetar i Autoritetit Kombëtar Anti-Korrupsion të Italisë.*

*“Kjo Konferencë është një dëshmi e rëndësishme e angazhimit të qëndrueshëm të Shqipërisë në drejtim të respektimit të të drejtës për informim, transparencës dhe gjithëpërfshirjes në botën gjithnjë e më të ndërlidhur që po jetojmë” - nga përshëndetja e **z. Tawfik Jelassi**, Asistent Drejtor i Përgjithshëm për Komunikimin dhe Informacionin në UNESCO.*



*“Fakti që ICIC mbahet në Tiranë dëshmon për progresin e rëndësishëm që Shqipëria ka shënuar, sidomos në dekadën e fundit, në garantimin e të drejtës për informim dhe rritjes së transparencës së sektorit publik” - nga përshëndetja e **z. Darian Pavli**, gjyqtar në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Strazburg.*

Panel 1 - Empowering Vulnerable Groups through Access to Information and Transparency

Panel brought together speakers from diverse sectors that engage in a comprehensive discussion on the critical issues surrounding transparency in the context of vulnerable groups and to address matters such as exploring ways on ensuring transparency for those groups, and what efforts need to be made by information regulators to ensure them with access to information.



Paneli 1 - Fuqizimi i grupeve vulnerabël përmes aksesit në informacion dhe transparencës

Paneli mbledhi së bashku folës nga sektorë të ndryshëm, ku u përfshirë në një diskutim gjithëpërfshirës mbi çështjet kritike që lidhen me transparencën në kontekstin e grupeve vulnerabël dhe për të adresuar çështje të tilla si kërkimi i mënyrave për sigurimin e transparencës për këto grupe dhe çfarë përpjekjesh duhen bërë nga autoritetet për t'u siguruar atyre akses në informacion.

Moderator/Moderatore

Kishali Pinto-Jayawardena - Right to Information Commissioner, RTI Commission of Sri Lanka/Komisionere për të Drejtën e Informimit e Sri Lankës

Panelists/Panelistë

Laura Neuman - Senior Advisor, Carter Centre, USA/Këshilltar i Lartë, Qendra Karter, SHBA

Sabina Aliyeva - Ombudsman of Azerbaijan/Avokate e Popullit, Azerbajxhan

Abdul Malek - Chief Information Commissioner, Information Commission of Bangladesh/Komisioneri për të Drejtën e Informimit të Bangladeshit

María Gracia Andía - Director of Buenos Aires Guarantor Body, Argentina/Drejtoresh e Autoritetit për të Drejtën për Informim, Buenos Aires, Argjentinë (online)



Panel 2 - Role of civil society and media in promoting access to information and transparency

In this dynamic panel brought together representatives from civil society, media and access to information regulators for a robust debate on the critical topic of access to information. Recognizing the indispensable role these stakeholders play in shaping transparent, accountable societies, this panel explored challenges, successes, and collaborative strategies in ensuring access to information.



Paneli 2 - Roli i shoqërisë civile dhe mediave në promovimin e aksesit në informacion dhe transparencës

Ky panel dinamik mbledhi së bashku përfaqësues nga shoqëria civile, media dhe zyrtarë të autoriteteve të të drejtës për informim, në një debat të fuqishëm mbi temën kritike të aksesit në informacion. Duke njohur rolin e domosdoshëm që luajnë këta aktorë në formimin e shoqërive transparente dhe të përgjegjshme, ky panel eksploroj sfidat, sukseset dhe strategjitë bashkëpunuese për të siguruar aksesin në informacionin me karakter publik.

Moderator/Moderatore

Flutura Kusari - Senior Legal Advisor, European Centre for Press & Media Freedom/Këshilltare e lartë ligjore, Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit

Panelists/Panelistë

Anjali Bharadwaj - Executive Director, Founder of Satark Nagrik Sangathan (SNS), India/Drejtor i Përgjithshëm i organizatës “Shoqëria për Iniciativat e Vigjilencës Qytetare”, Indi

Elona Hoxhaj - Director General, Information and Data Protection Commissioner, Albania/Drejtoresh e Përgjithshme e të Drejtës për Informim, Shqipëri



Caroline Maynard - Information Commissioner of Canada/Komisionere e Informimit, Kanada

Blanca Lilia Ibarra Cadena - INAI Commissioner, Mexico/Komisionere, Anëtare e Bordit të INAI, Meksikë (online)

Gilbert Sendugwa - African Freedom Information Center/Qendra Afrikane për të Drejtën e Informimit



Parallel Session I - Proactive transparency through digital tools and open data initiatives

This panel discussed the innovative landscape of proactive transparency, exploring the dynamic synergy between digital tools and open data initiatives. As governments strive to be more accountable and responsive, this panel discussed how leveraging technology and embracing open data can shift transparency from reactive to proactive.

Sesioni Paralel I - Transparençë proaktive përmes mjeteve digjitale dhe nismave për të dhënat e hapura

Ky panel diskutoi peizazhin inovativ të transparençës proaktive, duke eksploruar sinergjinë dinamike midis mjeteve digjitale dhe iniciativave për të dhënat e hapura. Ndërsa qeveritë përpiqen të jenë më të përgjegjshme dhe reaguese, paneli diskutoi se si shfrytëzimi i teknologjisë dhe përqafimi i të dhënave të hapura mund ta transformojë transparençën nga reaktive në proaktive.



Moderator/Moderator

Maria Baron - Global Executive Director of "Directorio Legislativo", Argentina/Drejtor i Përgjithshëm Botëror i organizatës "Directorio Legislativo", Argjentinë

Panelists/Panelistë

Adrian Alcalá Méndez - INAI's Chairman, Mexico/Kryetar i Bordit të Komisionerëve të INAI, Meksikë

Bruno Lasserre - President, Commission for access to administrative documents, France/President i Komisionit për Aksesin në Dokumentet Administrative, Francë

Marie Whelan - Policy Analyst in the Innovative, Digital and Open Government Division, OECD/Analist Politikash në Divizionin e Qeverisjes së Hapur, Inovacionit dhe Digjitalizimit, OECD

Meike Kamp - Berlin Commissioner for Data Protection and Freedom of Information/Komisionere për të Drejtën e Informimit, Berlin, Gjermani



Sokol Bardhi - Director General at the Ministry of Economy, Culture and Innovation, Albania/Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Shqipëri

Cherbett Karen L. Maralit - Undersecretary for Operations, Administration, Finance and GOCCs Presidential Communications Office, Philippines/Nën-Sekretar në Zyrën e Komunikimit të Presidentit, Filipine



Parallel Session II - Striking proper balance between access to information and data protection rights in the digital realm. How can we protect citizens' personal data while making efforts on ensuring digital information rights? This panel session explored the equilibrium between advancing access to information in the digital realm and preserving individual privacy rights. As we journey into an era of digitalization, our expert panelists discussed innovative strategies and ethical considerations to strike a harmonious balance between the imperative of transparency and the protection of personal data.



Sesioni Paralel II - Arritja e ekuilibrit të duhur midis të drejtës për informim dhe të drejtave të mbrojtjes së të dhënave në fushën digjitale. Si mund t'i mbrojmë të dhënat personale të qytetarëve ndërkohë që bëjmë përpjekje për të siguruar të drejtat e informacionit digjital? Ky sesion panel eksplori ekuilibrin midis avancimit të aksesit në informacion në sferën digjitale dhe ruajtjes së të drejtave individuale të privatësisë. Ndërsa udhëtojmë në një epokë digjitali-zimi, panelistët tanë ekspertë diskutuan strategji novatore dhe konsiderata etike për të vendosur një ekuilibër harmonik midis transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Moderator/Moderatore

Besa Velaj - Chief of Staff, Information and Data Protection Commissioner, Albania/Drejtoresh e Kabinetit në Zyrën e Komisionerit, Shqipëri

Panelists/Panelistë

Ulrich Kelber - German Federal Commissioner for Data Protection and Freedom of Information/Komisioneri Federal për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit, Gjermani

Krenare Sogojeva-Dërmaku - Information and Privacy Agency Commissioner, Kosovo/Komisionere e Informimit dhe Privatësisë, Kosovë



Tetyana Oleksiyuk - Vice President of the Access Info Group, Council of Europe/Zëvendëspresiedente e Grupit për të Drejtën e Informimit, Këshilli i Evropës

Ibrahim Seaga Shaw - Chairman and Information Commissioner, Right to Access Information Commission, Sierra Leone/Komisioneri për të Drejtën e Informimit, Sierra Leone.

UNESCO Panel - Mid-way through the implementation of the 2030 Agenda: Monitoring and Reporting on SDG 16.10.2
As a custodian of SDG 16.10.2 UNESCO has been working to strengthen guarantees of the right to information by promoting adoption of legal guarantees for access to information. Panelists discussed various initiatives aimed to strengthen work aimed to achieve Goal 16 Indicator 10.2 and also, current state of data on SDG 16.10.2 by presenting the results of the UNESCO 2023 Survey.



Paneli UNESCO - Përgjatë zbatimit të Agjendës 2030: Monitorimi dhe Raportimi mbi SDG 16.10.2 Si mbikëqyrës i indikatorit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG 16.10.2), UNESCO ka punuar për të forcuar garancitë për të drejtën e informimit duke promovuar miratimin e kornizave ligjore për aksesin në informacion. Panelistët diskutuan iniciativa të ndryshme që synojnë të forcojnë punën për përmbushjen e indikatorit 16.10.2 dhe gjithashtu, situatën aktuale me paraqitjen e rezultateve të Anketës 2023 të UNESCO.

Moderator/Moderator

Jaco du Toit - Chief, Global Access to Universal Information, UNESCO/Drejtor i Aksesit Global të Informimit, UNESCO

Panelists/Panelistë

Gitanjali Gutierrez – Information Commissioner, Information Commissioner's Office for Bermuda/Komisionere për të Drejtën e Informimit, Bermuda

Joan Barata Mir - Senior Legal Fellow, The Future of Free Speech, Vanderbilt University, USA/Bashkëpunëtor i lartë ligjor, E ardhmja e Fjalës së Lirë, Universiteti Vanderbilt, ShBA

Toby Mendel - Executive Director of the Center for Law and Democracy, Canada/Drejtor Ekzekutiv i Qendrës për Ligj dhe Demokraci, Kanada

Hlengiwe Dube - Centre for Human Rights, Faculty of Law, University of Pretoria, South Africa/Qendra për të Drejtat e Njeriut, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Pretorias, Afrika e Jugut (online)



ICIC Regional Meetings

Rrjeti Latin



Rrjeti Latin

Rrjeti Aziatik



Takime të Rrjeteve
Rajonale të ICIC

Rrjeti Amerikano-Verior



Rrjeti Afrikan

Raportime dhe mbyllja e punimeve të ditës së parë të Sesionit të Hapur



Cherbett Karen L. Maralit - Undersecretary for Operations, Administration, Finance and GOCCs Presidential Communications Office, Philippines/Nën-Sekretare në Zyrën e Komunikimit të Presidentit, Filipine

Ahmed Ahid Rasheed - Information Commissioner, Maldives/Komisioneri i Informimit, Ishujt Maldive



Gitanjali S. Gutierrez - Information Commissioner for Bermuda/Komisionere për të Drejtën e Informimit, Bermuda

Blanca Lilia Ibarra Cadena - INAI Commissioner, Mexico/Komisionere, Anëtare e Bordit të INAI, Meksikë

ICIC Working Groups Reporting

Raportimi i Grupeve të Punës të ICIC



*Transparency by Design Working Group, presented by **Warren Seddon**, ICO-FOI Director and **Cibelle Brasil**, Access to Information Director, Brazil/ Grupi i Punës për Transparencën e Projektuar

*Training Working Group, presented by **Blanca Lilia Ibarra Cadena**, INAI Commissioner, Mexico/Grupi i Punës së Trajnimeve



*Law cases Working Group, presented by **Adrián Alcalá Méndez**, INAI President Commissioner, Mexico/Grupi i Punës i Çështjeve Ligjore

*Gender and People in Vulnerable Situations Working Group, presented by **María Gracia Andía**, Head of ATI Guarantor Body, Buenos/Grupi i Punës për Çështjet Gjinore dhe Personave në Situata Vulnerabël (online)

Panel 3 - Future of the ICIC conference: What is next for information regulators? What are our common challenges and where should the ICIC work focus in the future strategic direction? On this forward-looking panel members and stakeholders of the International Conference of Information Commissioners (ICIC) discussed to collaboratively envision the future trajectory of the organization. Building upon the Strategic Plan 2021-2024, this session set the stage for the next phase of ICIC's work, emphasizing key focus areas, challenges, and innovative approaches on access to information and transparency.



Paneli 3 - E ardhmja e Konferencës ICIC: çfarë është më tej për autoritetet mbikëqyrëse? Cilat janë sfidat tona të përbashkëta dhe ku duhet të fokusohet puna e ICIC në drejtimin e ardhshëm strategjik? Në këtë panel largpamës, anëtarë dhe aktorë të inte-resuar të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informacionit (ICIC) diskutuan për të parashikuar në mënyrë bashkëpunuese të ardhmen e organizatës. Duke u mbështetur në Planin Strategjik 2021-2024, ky sesion vendosi piketat për fazën tjetër të veprimtarisë së ICIC, duke theksuar fushat kryesore të fokusit, sfidat dhe qasjet inovative për aksesin në informacion dhe transparencë.

Moderator/Moderator

Toby Mendel - Executive Director of the Center for Law and Democracy, Canada/Drejtor Ekzekutiv i Qendrës për Ligj dhe Demokraci, Kanada

Panelists/Panelistë

Blanca Lilia Ibarra Cadena - INAI Mexico, on behalf of the ICIC Chair/Komisionere, Anëtare e Bordit të INAI, Meksikë, në emër të Presidencës së ICIC

Pansy Tlakula - South Africa Information Regulator/ Komisionere e Informimit, Afrika e Jugut



Daren Fitzhenry - Information Commissioner's Office, UK/Zyra e Komisionerit të Informimit, Britania e Madhe

Andrew Ecclestone - Adjunct Senior Research Fellow, School of Government, Victoria University of Wellington, New Zealand/Bashkëpunëtor i Lartë Kërkimor, Shkolla e Qeverisjes, Universiteti Victoria i Wellington, Zelanda e Re.

Mbyllja e punimeve të Sesionit të Hapur

“I vlerësojmë si shumë të paçmueshme diskutimet dhe shkëmbimin e ideve përgjatë këtyre dy ditëve. Megjithatë, kemi një udhëtim të gjatë përpara për t'i vënë ato në jetë. Falënderoj për zemërsisht secilin prej jush për pjesëmarrjen, shpresoj që të kemi përmbushur pritshmëritë tuaja.”



ICIC XIV - Berlin 2025

Ulrich Kelber - German Federal Commissioner for Data Protection and Freedom of Information/ Komisioneri Federal për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit, Gjermani



Adrian Alcalá Méndez - INAI's Chairman, Mexico, on behalf of the ICIC Chair/Kryetar i Bordit të Komisionerëve të INAI, Meksikë, në emër të Presidencës së ICIC

Side Events - Aktivitete paralele

Council of Europe (CoE) - The Council of Europe Convention on Access to Official Documents, the first baseline evaluation

Këshilli i Evropës (KiE) - Konventa e Këshillit të Evropës për “Aksesin në dokumentet zyrtare”, vlerësimi i parë bazë



Centre for Law and Democracy (CLD) - How to Assess the Implementation of ATI Laws

Qendra për Ligjin dhe Demokracinë (QLD) - Si të vlerësohet zbatimi i legjislacionit për të drejtën e informimit

Carter Centre & World Bank - Accountability, Service Delivery, and Inclusivity: Exploring the Role of Information Commissioners

Qendra Carter dhe Banka Botërore - Llogaridhënia, ofrimi i shërbimeve dhe gjithëpërfshirja: eksplorimi i rolit të Komisionerëve të Informimit



Punimet e Sesionit të Mbyllur

Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të autoriteteve anëtare/vëzhguese u raportua rreth veprimtarisë së 12 muajve të kaluara të rrjeteve rajonale dhe të grupeve respektive të punës mbi zhvillimet më të rëndësishme në këtë fushë. Anëtarësia e Organizatës diskutoi dhe miratoi tekstin e Deklaratës Publike të punimeve të edicionit të XV ICIC “Transparenca dhe epoka digjitale: roli i Komisionerëve të Informimit dhe fuqizimi i qytetarëve”.



Autoriteti mexikano u rikonfirmua në krye të Komitetit Ekzekutiv të organizatës edhe në mandatin 2024-2027, ndërsa institucionet e Australisë dhe Kenias janë anëtarët më të rinj të këtij forumi për të njëjtën periudhë. Dy edicionet e ardhshme të Konferencës janë vendosur të mbahen në Gjermani në vitin 2025 dhe në Sierra Leone në

2026, në frymën e respektimit të parimeve të bashkëpunimit, diversitetit dhe gjithëpërfshirjes së anëtarësisë së organizatës. Kjo Konferencë Ndërkombëtare shërben si platformë qendrore për trajtimin e pikëpamjeve, sfidave dhe mundësive për të forcuar akoma edhe më shumë standardet në ushtrimin në praktikë të të drejtës për informim. Nga ana tjetër, ndërveprimi dhe bashkëpunimi me partnerët jashtë sferës publike



është i rëndësishëm për të nxitur kulturën e transparencës, për institucione të përgjegjshme dhe llogaridhënëse për një shoqëri demokratike funksionale.

Deklaratë Publike

Edicioni i 15-të i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit

Ne, Komisionerët e Informimit, anëtarë të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC), të mbledhur më 5 qershor 2024, në punimet e edicionit të 15-të të Konferencës sonë Vjetore, të mbajtur në mënyrë virtuale dhe në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë, paraqesim deklaratën e mëposhtme:

Duke kujtuar se Karta e Johannesburgut mbështet rrjetin e ICIC që shërben si gur themeli për bashkëpunimin global midis autoriteteve anëtare të ngarkuara me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtës për informim. Duke funksionuar mbi parimet e gjithëpërfshirjes, universalitetit, transparencës, përgjegjësisë, etikës, aksesueshmërisë, respektit dhe llogaridhënies, ICIC lehtëson ndërtimin e kapaciteteve dhe shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira. Nëpërmjet këtij rrjeti, komisionerët e informimit në mbarë botën bashkëpunojnë për të siguruar që e drejta themelore e aksesit në informacion të ruhet dhe të garantohet për të gjithë individët.

Duke theksuar se e drejta për informim si një shtyllë themelore e qeverisjes sociale, ekonomike dhe demokratike nënvizohet nga përfshirja e saj në akte të ndryshme ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut, duke përfshirë traktate të rëndësishme si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popullit, Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Deklarata e të Drejtave të Njeriut të Shoqatës së Kombeve të Azisë Juglindore, Konventa e Këshillit të Evropës për Aksesin në Dokumentet Zyrtare, Marrëveshja Rajonale për Aksesin në Informacion, Pjesëmarrja Publike dhe Drejtësia në Çështjet e Mjedisit në Amerikën Latine dhe Karaibet (Marrëveshja Escazú), ndër të tjera.

Duke pranuar Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, të miratuar njëzëri nga të gjitha Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara në 2015, e cila shërben si një kuadër kolektiv për nxitjen e paqes dhe prosperitetit global si për njerëzimin ashtu edhe për planetin. Kjo agjendë përfshin veçanërisht objektivin 16.10, i cili synon të sigurojë të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e lirive themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare, duke i nxitur vendet të miratojnë dhe zbatojnë garanci kushtetuese, statute dhe/ose politika për aksesin në informacion.

Duke njohur se Partneriteti i Qeverisjes së Hapur (OGP) luan një rol të rëndësishëm në nxitjen e transparencës, llogaridhënies dhe angazhimit të qytetarëve në qeverisje. Nëpërmjet platformës së saj bashkëpunuese, OGP inkurajon qeveritë të angazhohen për veprime konkrete që synojnë promovimin e të drejtës për informim dhe rritjen e aksesit të publikut në informacionin e mbajtur nga qeveria. Duke përqafuar parimet e hapjes dhe llogaridhënies, vendet pjesëmarrëse jo vetëm që forcojnë besimin midis qytetarëve dhe qeverive të tyre, por gjithashtu fuqizojnë individët që të kenë akses në informacion, të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes dhe t'i mbajnë autoritetet përgjegjëse për veprimet e tyre. Për më tepër, OGP shërben si një katalizator për zhvillimin e politikave dhe praktikave të së drejtës për informim, duke lehtësuar ndarjen e njohurive dhe të shkëmbimit të eksperiencës midis vendeve anëtare.

Duke marrë parasysh rolin kyç të shoqërisë civile dhe medias në promovimin e të drejtës për informim, duke kontribuar në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes demokratike, duke vënë theksin në punën e përkrahjes, monitorimit dhe promovimit. Përpjekjet e tyre shpesh përfshijnë fuqizimin e komuniteteve të marginalizuara për të ushtruar të drejtën e tyre për të pasur akses në informacion dhe për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse. Në mënyrë të ngjashme, media luan një rol jetik në sigurimin e aksesit të publikut në informacion duke hetuar dhe raportuar mbi aktivitetet e qeverisë, duke ekspozuar korru-psionin dhe duke i mbajtur zyrtarët përgjegjës. Gazetarët veprojnë si ndërmjetës midis qeverive dhe qytetarëve, duke ofruar informacion thelbësor për diskursin të informuar publik dhe vendimmarrje.

Vijon nga fq. 19

Përqafimi i teknologjive digjitale paraqet një mundësi të paprecedentë për të rritur transparencën duke mbajtur gjithashtu vlerat thelbësore si privatësia e individëve dhe konsideratat etike. Duke përdorur platformat dhe mjetet digjitale, qeveritë mund të rrisin aksesin e informacionit, të thjeshtojnë proceset administrative dhe të nxisin një angazhim më të madh të qytetarëve. Megjithatë, është e domosdoshme t'i jepet përparësi etikës dhe vlerave si mbrojtja e të dhënave, të drejtat e privatësisë dhe sigurisë kibernetike në zbatimin e iniciativave digjitale. Ruajtja e informacionit sensitiv dhe siguri i transparencës në lidhje me mbledhjen, ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave janë thelbësore për ruajtjen e besimit dhe respektit të publikut për privatësinë e individëve. Për më tepër, qeveritë duhet të jenë vigjilente në adresimin e risqeve të mundshme të përjashtimit dhe diskriminimit digjital, duke siguruar që risitë digjitale të ofrojnë përfitim në mënyrë të barabartë në të gjitha segmentet e shoqërisë.

Anëtarët e ICIC angazhohen për të:

1. promovuar transparencën duke përkrahur zbatimin e ligjeve dhe politikave të aksesit në informacion që nxisin hapjen dhe transparencën në autoritetet publike për të përmirësuar shërbimet, për të reduktuar asimetritë dhe për të promovuar pjesëmarrjen e qytetarëve;



2. ndihmuar në sigurimin e llogaridhënies së qeverisë duke mbikëqyrur respektimin e legjislacionit të LDI dhe duke hetuar ankesat për mosdhënie të informacionit ose menaxhimin jo efektiv;

3. bërë përpjekje për fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile dhe medias për t'u angazhuar në mënyrë aktive për promovimin e LDI në nivel qytetar, duke nxitur një kulturë transparence dhe të ndihmojë në

mundësimin e llogaridhënies së qeverisë dhe kështu të vijojnë të bashkëpunojnë në procesin e vendimmarrjes;

4. promovimi i inovacionit duke njohur potencialin e teknologjive digjitale për të rritur transparencën, dhe nëse është e aplikue-shme, duke marrë parasysh se iniciativat digjitale duhet të respektojnë të drejtat e privatësisë së individëve, të ruajnë aksesin në informacion në lidhje me vendimmarrjen e qeverisë dhe të respektojnë standardet etike;

5. zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuere publike për të edukuar qytetarët rreth të drejtës së tyre për akses në informacion, rolin e të drejtës për informim në qeverisjen demokratike dhe rëndësia e transparencës dhe llogaridhënies;

6. të zhvillojnë përpjekjet bashkëpunuese me aktorë të tjerë, si rrjeti ICIC, për të shkëmbyer praktikatat më të mira, rrisin kapacitetet dhe të promovojnë aksesin në informacion në nivel global;

7. t'i bëjnë thirrje agjencive të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave shumëpalëshe për të integruar aksesin në informacion si një nga mjetet më të rëndësishme të llogaridhënies, në agjendat e tyre ndërkohë që punojnë me qeveritë;

8. t'i bëjnë thirrje UNESCO për të organizuar një takim të të gjithë qeverive, përfshirë rregullatorët e informimit dhe të marrin ga-ranci universale për aksesin në informacion nga qeveritë;

9. të promovojnë parimet e transparencës digjitale (transparency by design) për të rritur dhënien e shpejtë të informacionit për të gjithë popullatën, duke marrë parasysh transparencën në fazat fillestare të projektimit të sistemeve të reja, proceseve administrative, procedurave dhe modelet e qeverisjes dhe integritit të tyre në punën e përditshme.

Njohuri të paçmueshme për të rritur transparencën dhe aksesin në informacion

*Fjala e Komisionerit Dervishi në mbyllje të Konferencës XV ICIC

“Ndërsa e mbyllim konferencën tonë, ndjehem i përmbushur me një ndjenjë të thellë arritjeje dhe mirënjohjeje. Gjatë ditëve të fundit, ne jemi angazhuar në diskutime të forta, kemi ndarë njohuri të paçmueshme, për të rritur transparencën dhe aksesin në informacion në vendet tona.

Një mirënjohje e veçantë shkon për ata që na besuan organizimin e këtij eventi:

për Komitetin Ekzekutiv që na besoi zhvillimin e Konferencës, për Sekretariatit për punën e tij të madhe dhe të palodhur, për Komitetin e Planifikimit. Gjithashtu, dua të shpreh mirënjohjen time të veçantë për partnerët tanë, Qeverinë dhe institucionet shqiptare dhe ata që na mbështetën në organizimin e kësaj Konference.

Një vlerësim i veçantë shkon për stafin tonë teknik për mbështetjen e tyre, për stafin e angazhuar në organizimin e shërbimeve të ndryshme në dobi të Konferencës. Do të kërkoja këtu edhe një duartrokitje të madhe për përkthyesit tanë.

E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, më lejoni të them disa fjalë për të gjithë ata që gjatë muajve të fundit kanë ndarë me mua përgjegjësinë për të planifikuar këtë Konferencë dhe gjithë lodhjen dhe presionin e punës që vjen me një organizim të tillë: stafin e Zyrës së Komisionerit, faleminderit të gjithëve.

Dëshiroj të përgëzoj kolegët tanë të INAI për rizgjedhjen e tyre në rolin e Presidencës dhe Sekretariatit të Konferencës së ICIC për një mandat tjetër. Mirëpresim që të vijojmë të punojmë së bashku.

Gjithashtu, më lejoni t'i përgëzoj anëtarët e sapo zgjedhur të Komitetit Ekzekutiv, konkretisht, dëshiroj të përshëndes autoritetet e Australisë dhe Kenias.

Ndërsa ktheheni në vendet tuaja, le të mbajmë me vete njohuritë e fituara dhe lidhjet e krijuara gjatë kësaj konference.

Dua ta mbyll me një shprehje të njohur të vendit tim: shtëpia e shqiptarit i takon zotit dhe mikut!”






XV ICIC, konsolidim i lidershit të organizatës për promovimin e të drejtës për informim


Komisioneri z. Besnik Dervishi, priti në një takim znj. Blanca Lilia Ibarra, anëtare e Bordit të Komisionerëve të INAI Meksikë,

në cilësinë e kreut të Komitetit Ekzekutiv të ICIC, dhe pjestarë të Sekretariatit.

Palët ndanë të njëjtin mendim, se zhvillimi i edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (XV ICIC), në Tiranë, në datat 3-5 qershor 2024, ishte një sukses për këtë organizatë, në rrugën e konsolidimit të lidershit të saj në botë për promovimin e të drejtës për informim, sidomos, në optikën e zhvillimeve teknologjike. Nga ana tjetër, aktiviteti i shërbeu edhe forcimit të bashkëpunimit, si mes institucioneve homologe, ashtu edhe me partnerët e shoqërisë civile, botës akademike apo medias, duke ndarë eksperiencat më të mira për garantimin e kësaj të drejte themelore të individit dhe sigurimin e standardeve më të larta në ushtrimin praktik të saj.

Takimi u zhvillua në kuadër të veprimtarisë për hartimin e konkluzioneve të Konferencës dhe vlerësimit të kapaciteve të domosdoshme për forcimin e rolit të organizatës në arenën ndërkombëtare. Gjatë tij, delegacioni meksikan vlerësoi, njëkohësisht, përkushtimin dhe punën e palodhur të Zyrës së Komisionerit në organizimin e këtij aktiviteti madhor, si dhe për mikpritjen karakteristike shqiptare për promovimin e vlerave më të spikatura të historisë, kulturës dhe trashëgimisë sonë kombëtare.





Revista “Informim Dhe Privatësi”

Përgatitet dhe botohet nga

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit

dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Qershor 2024

Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5


Kodi postar 1001

Tiranë

Tel: +355 42237200

Nr. i gjelbër: 08002050

www.idp.al



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**